

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-175/11**

**Prishtinë, 21 qershor 2012**

Në çështjen juridike të:

**D.L., personalisht dhe**

**R.L.,**

**M.L.,**

**N.L.,**

**D.L.,**

**G.L. dhe**

**L.H., nëpërmjet përfaqësueses së tyre D.L.**

**Paraqitësit e kërkesës/Palët ankuese**

**Kundër**

**M.B.**

**Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës **KPCC/D/A/108/2011** (lënda është regjistruar në AKP me numrat **KPA40940, KPA40941, KPA40942, KPA40943 dhe KPA40944**) dhe **KPCC/D/A/110/2011** (lënda është regjistruar në AKP me numrin **KPA40945**), të datës 13 maj 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 6 qershor 2012, mori këtë

### AKTGJYKIM

- 1- Pranohet ankesa.
- 2- Ndryshohen vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës **KPCC/D/A/108/2011** (lënda është regjistruar në AKP me numrat **KPA40940, KPA40941, KPA40942, KPA40943 dhe KPA40944**) dhe **KPCC/D/A/110/2011** (lënda është regjistruar në AKP me numrin **KPA40945**), që të dyja të datës 13 maj 2011, dhe vendimet e ndërlidhura individuale të **KKPK-së**, lidhur me kërkesat e harruara të **R.L., M.L., N.L., D.L., G.L. dhe L.H.**, të përfaqësuar nga **D.L.**
- 3- Pranohet kërkesa e paraqitur me 17 korrik 2007 nga **D.L.** në emër të **R.L., M.L., N.L., D.L., G.L. dhe L.H.**, e regjistruar me numrat **KPA40940, KPA40941, KPA40942, KPA40943, KPA40944, KPA40945**.
- 4- Konfirmohen të drejtat pronësore të **R.L., M.L., N.L., D.L., G.L. dhe L.H.** për secilin prej tyre për 1/7 e pjesës ideale të:
  - ngastrës nr. 1096 – më sipërfaqe prej 0 ha 12 ari e 26 metra katror, që gjendet në Gojan-preko reke, Skivjan, Gjakovë;
  - ngastrës nr. 1097 më sipërfaqe prej 0 ha 6 ari e 27 metra katror, që gjendet në Gojan- dvoriste, Skivjan, Gjakovë;
  - ngastrës nr. 1098/1, më sipërfaqe prej 0 ha 59 ari e 60 metra katror, që gjendet në Gojan-Okucnica, Skivjan, Gjakovë;
  - ngastrës nr. 1098/2, më sipërfaqe prej 0 ha 28 ari e 90 metra katror, që gjendet në Gojan-Lokvan, Skivjan, Gjakovë;
  - ngastrës nr. 1099/1, më sipërfaqe prej 1 ha 10 ari e 42 metra katror, që gjendet në Gojan-Strnista, Skivjan, Gjakovë;

- shtëpisë dhe objekteve tjetra prej 346 metra katror që ndodhen në ngastrën 1097 që gjendet në Gojan-dvoriste, Skivjan, Gjakovë.
- 5- R.L., M.L., N.L., D.L., G.L. dhe L.H. gjithashtu iu jepen në posedim pronat e kërkuara.
- 6- Çdo person që ka uzurpuar pronën duhet ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dorëzimi i këtij aktgjykimi; në rast të mosveprimit në përputhje me këtë urdhërese, personi do të dëbohet nga prona nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm.
- 7- Shpenzimet e procedurës do të mbulohen nga gjykatat dhe do të paguhen nga burimet buxhetore.

#### **Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

Me 17 korrik 2007, D.L. ka paraqitur disa kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar që të njëjët si pronare e ngastrës nr. 1096 - më sipërfaqe prej 0 ha 12 ari e 26 metra katror, që gjendet në Gojan-preko reke, Skivjan, Gjakovë; - ngastrës nr. 1097 më sipërfaqe prej 0 ha 6 ari e 27 metra katror, që gjendet në Gojan-dvoriste, Skivjan, Gjakovë; ngastrës nr. 1098/1, më sipërfaqe prej 0 ha 59 ari e 60 metra katror, që gjendet në Gojan-Okucnica, Skivjan, Gjakovë; ngastrës nr. 1098/2, më sipërfaqe prej 0 ha 28 ari e 90 metra katror, që gjendet në Gojan-Lokvan, Skivjan, Gjakovë; ngastrës nr. 1099/1, më sipërfaqe prej 1 ha 10 ari e 42 metra katror, që gjendet në Gojan-Strnista, Skivjan, Gjakovë; shtëpisë dhe objekteve tjetra prej 346 metra katror që ndodhen në ngastrën 1097 që gjendet në Gojan-dvoriste, Skivjan, Gjakovë.

Paraqitësja e kërkesës ka sqaruar se ajo është pronare e pronave në fjalë të cilat i kishte fituar me anë të trashëgimisë pas vdekjes së bashkëshortit të saj A.L.. Ajo ka deklaruar se pronat ishin uzurpuar nga persona të panjohur. Në kërkesë janë listuar gjatë përsosna si palë të interesuara: R.L., M.L., N.L., D.L., G.L. dhe L.H.. AKP-ja nuk i ka konsideruar ata në proces as si paraqitës të kërkesës e as si palë përgjegjëse në kërkesë. AKP-ja nuk e ka pyetur paraqitësen e kërkesës nëse ajo i përfaqësohet ata në procedurë dhe nuk ka kërkuar nga ajo autorizimin..

Për të mbështetur kërkesën e saj, paraqitësja e kërkesës ka paraqitur në AKM dokumentet në vijim:

- Ekstraktin e fletës poseduese nr. 409, të lëshuar nga Komuna e Gjakovës, Zona Kadastrale e Skivjanit me 6 shkurt 2000 (Republika e Serbisë), që tregon se D.L. dhe R.L., M.L., N.L., D.L., G.L. dhe L.H. kishin qenë në posedim të pronave kontestuese dhe
- Letërnjoftimin nr. 201169, të lëshuar nga Komuna e Gjakovës, me 8 korrik 2004 (Republika e Serbisë).

Më vonë gjatë procedurës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur dokumentet në vijim:

- Certifikatën e martesës nr. 7, të lëshuar nga Komuna e Gjakovës me 8 2004; dhe
- Autorizimin e paraqitësit të kërkesës që i është dhënë përfaqësuesit të saj ligjor A.L., të verifikuar nga Gjykatat Komunale e Kraveves-Serbia me 21 maj 2009,

Ekipi i AKP-së për njoftim ka bërë njoftimin e pronave duke vendos shenjat në secilën prej tyre në vitin 2007 dhe 2008 (për pronat e ndryshme). Disa notifikime ishin përsëritur në vitin 2010. Në një fazë të mëvonshme, AKP-ja ka kontrolluar njoftimet bazuar në “ortofotot dhe koordinatat e GPS-it”. Ato kanë konfirmuar se notifikimi ishte bërë siç duhet.

Sa i përket disa prej pronave për të cilat pala përgjegjëse në kërkesë ka kërkuar të drejtat pronësore, por pohimet e tij ishin kundërshtuar nga aktgjykimi aktual nr. 107/45, i datës 1 tetor 1945, të marrë nga Gjykata Popullore e Qarkut e Gjakovës, si dhe nga aktgjykimi nr. 25/45, i datës 9 nëntor 1945, i marrë nga Gjykata Popullore e Qarkut të Prizrenit. Është vërtetuar se në të kaluarën në vitin 1945, kishte pasur një kontest pronësor lidhur me ngastrën ndërmjet familjeve të paraqitëses të kërkesës dhe palës përgjegjëse në kërkesës dhe se ishte vendosur në favor të këtij të parit.

AKP-ja ka kontaktuar me palën përgjegjëse në kërkesë më qëllim që të kërkoj nga ai që të paraqes dokumentet plotësuese. Shënimet e korrespondencës ndërmjet AKP-së dhe palës përgjegjëse në kërkesë tregojnë se pala përgjegjëse në kërkesë ka refuzuar që të paraqes dokumente tjera për të dëshmuar pronësinë.

Me 13 maj 2011, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimet e tij KPCC/D/A/108/2011 dhe KPCC/D/A/110/2011 ka gjetur se paraqitësja e kërkesës kishte vërtetuar se ajo është pronar e 1/7 së pjesës ideale të pronave të kërkuara. Komisioni ka urdhëruar se paraqitëses së kërkesës duhet t'i jepet posedimi i pronave të kërkuara dhe se pala përgjegjëse në kërkesë apo ndonjë person që ka uzurpuar pronat duhet t'i liroj ato brenda 30 ditëve nga dorëzimi i urdhëresës, përndryshe do të dëbohet nga aty.

Vendimet i janë dorëzuar paraqitëses së kërkesës me 13 shtator 2011.

Vendimet i janë dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë me 27 shtator 2011.

Me 10 tetor 2011, paraqitësja e kërkesës (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, duke kundërshtuar vendimin e KKPK-së.

Pala ankuese ka cekur se Komision e kishte konsideruar gabimisht kërkesën e saj si individuale e jo si një kërkesë të përbashkët, ndonëse dokumentet mbështetëse të bashkëngjitura në dosjen e lëndës ishin identike për të gjithë bashkë-pronarët. Ajo ka pohuar se ata (ajo dhe fëmijët e saj: R.L., M.L., N.L., D.L., G.L. dhe L.H.) që të gjithë e kanë trashëguar pronën e kërkuar në të njëjtën kohë në procedurë provuese pas vdekjes së bashkëshortit të saj dhe se ata asnjëherë nuk kanë bërë ndarjen fizike të pronës. Për më tepër, ajo konsideron se madje edhe në fletën poseduese, ata janë cekur si pronarë, secili nga ta i 1/7 të pjesës ideale të pronës së kërkuar dhe gjithashtu ata janë përmendur si palë me interes në të gjitha kërkesat (KPA40940, KPA40941, KPA40942, KPA40943, KPA40943, KPA40944 dhe KPA40945) të paraqitura në AKP.

Pala ankuese pohon se AKP-ja është dashur që të përcaktojë në vendimin e saj edhe të drejtën pronësore të këtyre personave, duke e konsideruar këtë kërkesë si të bashkuar, pasi që ajo ishte i vetmi person që përfaqësonte tërë familjen.

Veç kësaj, ajo ka deklaruar se mbase janë bërë gabime teknike nga Komisioni dhe se kjo mund të korrigjohet lehtë pa ndryshuar përmbajtjen dhe faktet. Ajo gjithashtu ka deklaruar se asnjëri nga bashkëpronarët nuk është informuar fare dhe askush nga AKP-ja nuk ka kërkuar ndonjë deklaratë para AKP-së dhe për këtë arsye ajo është e bindur se i kishte përfaqësuar ata.

Përfundimisht, ajo ka kërkuar nga Gjykata Supreme që të rishqyrtojë vendimin e njëjtë dhe të vendos për të gjithë bashkëpronarët apo palët e interesuara.

Ankesa i është dorëzuar palë përgjegjëse në kërkesë (tani e tutje: pala përgjegjëse në ankesë) M.B.. Pala përgjegjëse në ankesë nuk është përgjigjur.

NË pajtim me obligimin që të kontrollojë sipas detyrës zyrtare nëse personi që paraqitet si përfaqësues posedon autorizimin për përfaqësim (neni 93.4 i LPK-ës) gjykata ka kërkuar nga D.L. të oferojë autorizimin, gjë që ajo edhe e ka bërë.

Ajo kishte paraqitur autorizimin e datës 27 qershor 2007. Përmes këtij autorizimi paraqitësit e kërkesave R.L., M.L., N.L., D.L., G.L. dhe L.H. kishin autorizuar nënën e tyre, paraqitësen e kërkesës D.L. t'i përfaqësonte ata në cilëndo procedurë ligjore në lidhje me pronat në fshatin e tyre Skivjan dhe të përshkruara në fletën poseduese 409. Edhe pse nuk ishte thënë në mënyrë shprehimore, leximi i i dokumentacionit në lidhje me fletën poseduese të sipërcekur provon faktin se paraqitësit e kërkesës të përmendur kishin autorizuar nënën e tyre (jo avokatin) për t'i përfaqësuar ata në cilëndo procedurë ligjore që ka të bëjë me pronat e kërkuara. Autorizimi ishte lëshuar në përputhshmëri me kërkesat ligjore të nenit 96, në lidhje me nenin 95 dhe nenin 97, paragrafi 1, hipoteza e parë e Ligjit të Procedurës Kontestimore (SFRJ 4/1977). Autorizimi i dhënë personit i cili nuk është avokat është i formës së shkruar dhe përfaqësuesi ka të drejtat e ndërmarrjes së të gjitha veprimeve procedurale për të cilat në mënyrë shprehimore është i nevojshëm autorizimi – p.sh tërheqja e kërkesës së paraqitur, pranimit ose heqja dorë nga kërkesa e paraqitur, lidhje e marrëveshjes, heqja dorë ose mosushtimi i mjeteve juridike, etj. Në rastin konkret këto nuk janë relevante meqë ato si veprime nuk janë marrë nga ana e përfaqësuesit të tyre. Më vonë ai kishte paraqitur kërkesë pranë AKP-ës dhe më pas edhe ankesën në Gjykatën Supreme të cilat veprime ligjore ishin marrë në kuadër të kufijve të autorizimeve të dhëna përmes autorizimit. Meqenëse nuk ka pasë tërheqje autorizimi të paraqitur para Gjykatës (neni 94.2 i LPK-ës), Gjykata konsideron se të gjitha veprimet e ndërmarrura nga përfaqësuesja D.L. në emër të gjashtë paraqitësve të kërkesave/ankesave janë të vlefshme.

### **Arsyetim ligjor:**

Neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 përshkruan “Pas pranimit të kërkesës, Sekretaria ekzekutive e njofton dhe i dërgon nga një kopje të kërkesës çdo personi, përpos paditësit, i cili aktualisht ushtron apo pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës dhe bën përpjekje të arsyeshme për të njoftuar çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në këtë pronë “

Neni 11.3 (c) dhe (d) po aty parasheh se KKKP-ja mund të ndërmarrë masa të tjera procedurale nëse i shihet të nevojshme për përshpejtimin e vendimarrjes.

Neni 11.1 po aty parasheh se dispozitat ligjore të Ligjit mbi Procedurën Administrative aplikohen përshtatshëmrisht në procedurën e KKKP-ës, përveç nëse nuk parashihet ndryshe me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 dhe me Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut Nr. 2007/5.

Neni 39.2 i Ligjit mbi Procedurën Administrative – Ligji Nr. 02/L-28 – parasheh që pa marrë parasysh se dispozitat ligjore të paragrafit 1 të të njëjtit nen, organet publike administrative duhet, nëse është e mundur që ti përmirësojnë kërkesat e palëve, duke mos paragjykuar interesat e palëve të interesuara. Kjo zgjedhje

ligjore është refleksion i parimit të ligjshmërisë, ashtu siq është parcaktuar në nenin 3.1 po aty, mbi bazën e të cilit organet publike administrative do ti ushtrojnë aktivitetet administrative në përputshmëri me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë, mbrenda kompetencavë dhe me qëllimin e këtyre kompetencave të dhëna. Tjetër manifestim i parimit të ligjshmërisë i cili është i rëndësishëm në rastin konkret është ai i formuluar në nenin 3.2 po aty që parasheh se organet administrative publike duhet të sigurojnë zbatimin e akteve të tyre administrative, vendimet e përshtatura, ashtu siq janë edhe vendimet e KKPK-ës.

Neni 55 po aty gjithashtu parasheh se organet kompetente duhet të kërkojnë dhe duhet të jenë në dijeni me të gjitha faktet me qëllim të nxjerrjes së vendimit përfundimtar, duke shfrytëzuar të gjitha menyrat e vërtetimit të parapara me Ligj. Kjo zgjedhje në mënyrë të vazhdueshme shoqërohet nga parimi i objektivitetit në procedurën administrative sipas nenit 7.1 po aty “Gjatë aktivitetit administrativ, organet publike administrative duhet të shqyrtojnë dhe vlerësojnë të gjithë faktorët që janë të lidhur me aktet e veqanta administrative. Në linjë të njëjtë është edhe neni 5.3 po aty, i cili parasheh që gjatë procedurës administrative, zyrtarët të cilët drejtojnë procedurën duhet të shqyrtojnë çdo faktorë dhe parim objektiviteti si rregullë themelore.

D.L. mbi bazën e autorizimit të datës 27 qershor 2007 ka paraqitur kërkesat në AKP në emrin e saj dhe në emrin e fëmijëve të saj për palujtshmëritë e sipërcekura duke kërkuar të drejtën e pronësisë në 1/7 e pjesës ideale e ngastrave kadastrale Nr. 1096 – në sipërfaqe prej 0 ha 12 ari e 26m<sup>2</sup>, në vendin Gojan-preko reke, Skivjan, Gjakovë; ngastrën 1097 në sipërfaqe prej 0 ha 6 ari e 27m<sup>2</sup>, në Gojan-oborr, Skivjan, Gjakovë, ngastra 1098/1, me sipërfaqe prej 0 ha 59 ari e 60 m<sup>2</sup>, Gojan-Okucnica, Skivjan, Gjakovë, ngastra 1098/2, me sipërfaqe prej 0 ha 28 ari e 90 m<sup>2</sup>, Gojan-Lokvan, Skivjan, Gjakovë, ngastra 1099/1, në sipërfaqe prej 1 ha 10 ari e 42m<sup>2</sup>, Gojan-Strnista, Skivjan, Gjakovë, shtëoi dhe ndërtesa të tjera në sipërfaqe prej 346m<sup>2</sup>, të ndërtuara në ngastrën 1097, Gojan-oborr, Skivjan, Gjakovë, dhe mbi bazën e Fletës Posedues Nr. 409, lëshuar nga Komuna e Gjakovës, Zona Kadastrale Skivjan ata janë posedues në 1/7 e pjesës ideale të këtyre parcelave. Pavarësisht kësaj KKPK-ja nuk i ka pranuar si paraqitës të kërkesave R.L., M.L., N.L., D.L., G.L. dhe L.H..

KKPK-ja do të duhej që ti pranonte si paraqitës kërkesash. Nëse Komisioni do të konsideronte se kërkesat nuk janë të qarta për sa i përket faktit kush janë palët, do të duhej t'i shfrytëzonte udhëzimet e dhënë në nenin 39 të Ligjit të Procedurës Administrative dhe që të përmirësonte kërkesën e paraqitur pas pyetjes së paraqitësit të parë të kërkesës në lidhje me paraqitësit e tjerë të kërkesave dhe nëse ajo i përfaqëson ata. Duke vepruar kështu Komisioni la nxjerrë vendim duke bërë shkelje të parimeve të objektivitetit (argument sipas nenit 3.1 të LPA). Prandaj, Kolegji i Apelit mbrenda autoritetit të vet Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 ndryshon vendimin duke i pranuar kërkesat e gjashtë paraqitësve të kërkesave si të bazuara.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në përputhje me nenin 8.4 të Shtojcës III të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Gjykatës Supreme. Megjithatë, në rastin aktual ankesa është e pranuar si e bazuar, prandaj ankuesit nuk i ngarkohet pagesa e shpenzimeve gjyqësore

### **Këshillë juridike**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it